



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 153, Datë 03.07.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“URADRIN” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, dhe nenit 10, pika 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, nenit 19, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 03.07.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “URADRIN” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

Konstatohet se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 455 datë 15.06.2018, shoqëria “URADRIN” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “URADRIN” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” si më poshtë:
 - Formati dhe Dokumentacioni për aplikim (neni 9 pika 1) Plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “e”). Plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3). Plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9 pika 4.8). Plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Nenin 9 pika 2, gërma “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “*Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “URADRIN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.